
DRUG ADDICTION AND CRIME

Nexhmedin Sejdiu

College Biznesi, Faculty of Law, Prishtina, Kosovo, nexhmedinsejdiu@outlook.com

Abstract: The beginning of the first signs of drug use as a harmful phenomenon in society appeared in the countries of Western Europe and North America, around the XIX century. Sharp social problems cause drug abuse to increase at a high rate from year to year, slowly becoming a very disturbing phenomenon for man and society itself. Began to be discovered and produced from classic drugs under their products with very strong action effect and consequently quite harmful to human health such as: morphine, heroin, cocaine, etc. In this situation which was degrading day by day, different states began to take legal measures, providing by law as criminal offenses all actions related to the cultivation, production, transportation, sale and use of various drugs but yet this could not have prevented such a thing, although they were provided under different codes as criminal offenses. In 1960-1970, the International Organizations signed International Agreements in the field of control and fight against drugs, as the problems in this sector became very worrying. The United Nations since 26.06.1988 designated this date as the International Day for the Elimination of All Forms of Discrimination against Women. Taking these measures, has influenced to combat and prevent the negative phenomenon with drugs in all legal, economic, medical, social and social plans, so as not to endanger the life and future of today's youth. This topic is very broad and needs to be addressed all over the world because the number of its users is increasing every day even more and especially by minors so it should be treated as a topic in schools and television in order to become information about the dangers posed by drugs in order to achieve prevention so that young people understand the negative effects caused by drugs and do not fall prey to the desire or curiosity to try it as well as persons who are active users of it. not to be stigmatized by society but to be helped by society, district and rehabilitation bodies so that drug users recover from drug addiction and integrate. This paper aims to contribute to the field of jurisprudence by contributing to the information provided with it to serve the younger generations.

Keywords: Drugs, Law, Drug Addiction, Rehabilitation, Integration.

NARKOMANIA DHE KRIMINALITETI

Nexhmedin Sejdiu

Kolegji Biznesi- Fakulteti Juridik, Prishtinë, Kosovë, nexhmedinsejdiu@outlook.com

Abstrakt: Filli i shfaqjes së shenjave të para të përdorimit të drogës si dukuri e dëmshme në shoqëri është shfaqur në vendet e Evropës Perëndimore dhe Amerikës Veriore, rreth shekullit të XIX. Problemet e mprehta sociale u bënë shkak që nga viti në vit abuzimi me drogën të rritej me ritme të larta duke u shëndrruar dal ngadal në një fenomen mjaft shqetësues për njeriun dhe vet shoqërinë. Filluan të zbuloheshin dhe prodhoheshin nga drogat klasike nën produkte të tyre me efekt veprues shumë të fortë dhe rrjedhimisht mjaft të dëmshëm për shëndetin e njeriut si: morfina, heroina, kokaina, etj. Në këte situatë e cila po degradonte nga dita në ditë, shtetet e ndryshme filluan të merrnin, masa ligjore duke parashikuar me ligj si vepra penale të gjitha veprimet që kishin të bënin me kultivimin, prodhimin, transportimin, shitjen dhe përdorimin e drogave të ndryshme por prap se prap kjo nuk mundi ta parandaloj një gjë të tillë, megjithëse ishin paraparë ndër kode të ndryshme si vepra penale. Në vitin 1960-1970 Organizatat Nderkombëtare²²⁷ nënshkruan Marrëveshje Nderkombëtare në fushën e kontrollit dhe luftës kundër drogave, pasi që veq problematikat në këte sektor u bënë mjaft shqetësuese.

Organizata e Kombeve të Bashkuara që nga data 26.06.1988 e cilësoi këtë datë si Ditën Nderkombëtare të Luftës kundër përdorimit dhe Shpërndarjes së Drogës. Marrja e këtyre masave, ka ndikuar që të luftohet dhe parandalohet fenomeni negativ me drogën në të gjitha planet juridike, ekonomike, mjekësore, sociale dhe shoqërore, që të mos rrezikohet jeta dhe e ardhmja e rinisë së sotme. Kjo temë është shumë e gjerë dhe e nevojshme të trajtohet në të gjithë botën sepse numri i përdoruesve të saj po rritet çdo ditë edhe më shumë e sidomos nga persona të mitur prandaj duhet të trajtohet si temë edhe në shkollat dhe televizione në mënyrë që të bëhet informimi për rreziqet që shkakton droga në mënyrë që të arrihet deri tek preventiva që të rinjë të kuptojnë efektet negative që i shkakton droga dhe të mos të bënë preh e dëshires apo kurreshtjes që ta provojnë atë si dhe personat të cilët janë përdorues aktiv të saj të mos stigmatizohen nga shoqëria por të ndihmohen nga shoqëria, rrethi dhe organet rehabilituese që

²²⁷ .S.Nushi, "Mbrojtja me avokat e personit gjatë kohës së shoqërimit, ndalimit ose arrestimit në flagrancë". Tribunë juridike, viti 2004, nr.46, f.51

përdoruesit e drogës të shërohen nga varësia e drogës dhe të bëhet integrimi i tyre. Ky punim ka për synim që të jap kontribut në fushën e jurisipodencës duke kontrubiar që informacionet e japura me të të shërbejnë edhe për gjeneratat e reja.

Fjalët kyqe: Droga, Ligji, Narkomania, Rehabilitimi, Integrimi.

1. HISTORIKU I DROGAVE

Është e ditur se drogat janë përdorur që në lashtësi. Duke filluar që në para histori, njerzit kanë përdorur disa ekstrakte bimore, për shkak të efekteve qetësuese të tyre, sidomos kur kishin dhimbje të forta të kokës apo pjesëve të tjera të organizmit përshebull në Lindjen e afërme konsumohej Hashashi, në Greqi Opiumi, në Kinë Marihuana dhe bima Koka në Amerikën Jugore. Konsumimi më i hershëm i lëndëve narkotike është i lidhur me ritet fetare, por më pas u përdor edhe për të përballuar mundimet e mëdha fizike. Droga është konsumuar gjatë gjithë historisë dhe anë e mban botës. Deri në shekullin e XIX drogat nuk kishin përhapje të gjerë, ishin të rrallë njerëzit që përdornin narkotik. Në këtë kohë dominonte alkoholi dhe duhani e më pak lëndët narkotike që ishin destinuar për intelektualët. Vlen të thuhet se deri në fund të shekullit XIX nuk kishte asnjë kufizim ligjor për tregtin e narkotikëve, gjithëqka ishte legale. Në këtë shekull filloj edhe prodhimi sintetik i drogave, kimistët u interesuan për përbërjen e narkotikëve duke arritur sintetizimin dhe më pas fabrikimin e substancave tjera të këtij lloji. Këto u emertuan me fjalën "drogë" term ky që në mesjetë nënkuptonte produkte me efekte dëmtuese.

Të gjitha drogat dehëse ose pijet narkotike për nga origjina mund të jenë: natyrore dhe sintetike.²²⁸ Natyrore janë ato droga dhe pije narkotike që gjenden në natyrë, kultivohen dhe rriten në natyrë, ndërsa droga dehëse apo pije narkotike sintetike janë ato të cilat nxirren nga lëndë të ndryshme e jo nga natyra. Në fillim të shekullit XX filloj një përhapje më e madhe e drogës. Në SHBA nga një testim i bërë në vitin 1913 rezultonte se kishte një qerek milion narkoman edhe vendet e tjera filluan të prekeshin nga kjo dukuri. Kjo i detyroi shtetet të nxirrnin ligje për lirin e prodhimit dhe tregtisë së narkotikëve. Për këtë arsye trafiku i drogës u bë i fshehtë dhe grupet kriminale morën rrugë për të shkuar në vendet furnizuese. Në vazhdim të shekullit XX, sidomos pas luftës së II-të botërore, trafiku dhe konsumimi i drogës mori përmasa të mëdha, në veçanti në vendet e zhvilluara perëndimore. Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara të dhjetëvjeçarit të kaluar numri i atyre që konsumonin drogën ishte 1.80 milion persona.

Në gjiron vjetore për me shumë se 900 miliard dollar trafiku i narkotikëve është biznesi më terheqës për organizatat kriminale të të gjitha llojeve. Në SHBA sot konsumojn rreth 60% të drogave ilegale botërore. Në Kanada nga një studim i kryer në vitin 1985, rezultojnë të jenë konsumues të drogës 14% e adoloshentëve dhe 21% e të rinjëve.

Vitet e fundit ka një rënje në prodhimin e drogës. Zyra e Kombeve të Bashkuara për kontrollimin e drogës, me bazë në Vienë ka deklaruar se gjatë viteve 1992 deri 1999, prodhimi i kokainës dhe heroinës kishte rënë rreth 20%, ndërsa në vitin 2000, rënja ishte 17% krahas me prodhimin ka ardhur duke u kufizuar edhe tegu i tyre. Kjo shpjegohet me luftën që është duke ju bërë trafikut të drogës²²⁹ si nga shtetet veq e veq, ashtu edhe në bashkëpunim midis tyre.

Mirëpo, përdorimi i drejtë dhe për qëllime mjeksore i pijeve narkotike mund të jetë dhe është ilaç, ndërkaq përdorimi jo mjeksorë shkakton sëmundjen e varësisë, narkomanisë (varsisht nga përdorimi i drejtë dhe jo i drejtë, pijet narkotike mund të jenë ilaç, ose helm) ku disa persona janë të prirur për të përdorur vazhdimisht narkotik me pasoja të rënda për shëndetin dhe për sjelljen e njeriut në shoqëri normale. Në të gjitha sistemet shoqërore, që njeh njerëzimi, narkotikët kanë qenë dhe sot janë substanca mjaftë të rrezikshme për njeriun të cilat shkaktojnë dehjen dhe dëmtimin pa masë të organizmit të njeriut, ndërkaq në aspektin financiarë shtojnë pasurimin e pa ndjersë, të pa bazë dhe fitim të kundërligjshëm të atyre që merren me shpërndarjen dhe shitjen e drogave të ndryshme dehëse.

Sot më tepër se kurr më parë, narkomania si dukuri mjaftë e rrezikshme dhe e dëmshme për shoqërinë është duke u paraqitur, dhe ka dalë në sipërfaqe për fat të keq, sidomos tek struktura e të rinjëve.

Narkomania, manifestohet në përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe pijeve të tjera narkotike e mund të thuhet se kjo dukuri është e përhapur shumë në shoqërinë bashkohore. Duke parë dinamikën e përhapjes së kësaj dukurie kriminale, mjaftë të dëmshme për shoqërinë, problematikat që ka sjell ky problem jo vetëm për mjeksinë por edhe në aspektin juridik, kanë bërë që të tërhiqet vëmendja edhe e juristëve dhe opinionit të tërë për ta luftuar dhe parandaluar atë me të gjitha forcat e mundshme dhe në të gjitha mënyrat. Njerëzit që abuzonin me drogën, jo vetëm që dëmtonin rëndë shëndetin e tyre, por shëndrroheshin në persona asocial, duke qenë kështu kontigjenti shoqërorë më i prirur për të kryer krime të rënda. Ajo shkakton pasoja të rënda për shëndetin psikik dhe fizik të njeriut.²³⁰ Narkomania mund të sjellë në pyetje jo vetëm shëndetin e individit por edhe jetën e gjeneratave të tëra të njerzimit.

²²⁸ Halili, Ragip. Kriminologjia, Prishtinë 2002, fq 47

²²⁹ Elezi, Ismet "Për reformën në drejtësi", Tribunë juridike, v.2005, nr.56, f.7

²³⁰ Halili, Ragip. Kriminologjia, botimi I VII 2011, Prishtinë, f.308

Sipas statistikave ndërkombëtare dhe atyre nacionale të cilat e përcjellin dukurin e narkomanisë ,sot flitet për shifra të mëdha prej miliona njerëzish të cilët përdorin dhe konsumojnë narkotik dhe janë bërë viktime të saj. Po ashtu qindra miliona njerëz në mënyra të ndryshme janë të kyqur lidhur me prodhimin, shitëblerjen, organizimin e rrjetit tregtar për shpërndarjen dhe keqpërdorimin e saj kundër ligjor për qëllimet delikuede e kriminale. Shënime dhe të dhëna të sakta të organizatave shoqërore, asociacioneve dhe institucioneve të ndryshme ndërkombëtare dhe nacionale të cilat mirren me trajtimin dhe studimin e dukurisë së narkomanisë flasin për numrin e madh të njerzve, e sidomos të rinjëve,që kanë humbur jetën ose kanë ngelur invalid të përjetshëm për shkak të përdorimit dhe varshmerisë nga droga dehëse.²³¹

Në këtë situatë e cila po degradonte nga dita në ditë, shtetet e ndryshme filluan të merrnin masa ligjore duke parashikuar me ligj si vepra penale të gjitha veprimet që kishin të bënin me kultivimin, prodhimin, transportimin, shitjen dhe përdorimin e drogave të ndryshme. Por prap se prap kjo nuk mundi ta parandaloj një gjë të tillë edhe pse ishin paraparë ndër kode të ndryshme si vepra penale.

Të gjitha drogat dehëse dhe pijet narkotike hyjnë në radhët e materieve toksike dhe helmuese që kjo gjendje e varshmerisë nga droga quhet helmim ose toksikomani,ndërsa vet konsumuesi shpesh quhet toksikoman.

Psikofarmakologjia- është shkencë e cila studion ndikimin e drogave psikoaktive. Prejardhja e fjalës **Farmakologji** është nga gjuha greke, **Pharmakon** do të thotë drogë-helm dhe logio që do të thotë shkencë. Farmakologjia është degë e biologjisë e cila për studim ka ndikimin e drogave, ajo po ashtu e defionon drogen se a është e krijuar nga njeriu apo është natyrale,se a është molekulare e cila krijon efekt biokimik apo psikologjik në qelizë, organe apo organizëm.Farmakologjia është zhvilluar në shekullin e XIX , departamentin e parë të kësaj dege e ka krijuar Rudolf Buchhelm në vitin 1847.²³² Dita botërore kundër abuzimit dhe trafikimit të drogave është data 26 qershor, ku është caktuar për herë të parë në më date 07 dhjetor 1987 nga Asambleja e Pergjithshme e Kombeve të Bashkuara të Amerikes, me qëllim të funksionimi të një bote pa drogë.²³³

Klasifikimi i drogave:Drogat për nga origjina mund të jenë natyrore dhe sintetike.Natyrore janë ato droga që gjenden në natyrë dhe nuk përpunohen dhe fitohen artificialisht ndërsa droga sintetike janë ato të cilat prodhohen në mënyrë artificial dhe përdoren si narkotikë.Fjala “narkotik”, shpjegohet me rrënjën e saj "narko", që nënkupton gjumë ose relacion me të. Pra, narkotik do të thotë përgjumje, ngathtësim, ilaç që përdoret si narkozë.Sipas Organizates Boterore te Shendetesise drogat i klasifikojme ne tre grupe:²³⁴**Stimulantet, Halucinogjenet, Depresantet.**

Stimulantet: quhen ndryshe edhe drogat eksituese. Në këtë kategori përfshihet: kokaina, atropina, amfetamina, kafeina, teina, nikotina. Stimulantët kanë efekte eksituese tek personat që i përdorin ato.Nga drogat e llojit stimulant më kryesorja është kokaina.

2. LLOJET E DROGAVE

Kokain/ Kokainhydrochlorin -Pluhuri i bardhë, njëra ndër drogat më të rrezikshme edhe me të përhapura, perfitohet nga gjethet e bimës Coca e cila rritet 600-1000 m lartësi në Amerikën jugore.Kokaina vepron në sistemin nervor qendror dhe shpie tek disponimi i mirë deri në eufori si dhe sjell ndjenjën e të qenit aktiv në punë. Vetëbesimi rritet kështu që konsumentët e kokainës janë shumë egocentrikë. Ndjenja e urisë dhe lodhjes zvogëlohet. Tek konsumimi i kokainës vije deri tek rregullimet e frymëmarrjes dhe pulsit të zemrës. Enët e gjakut ngushtohen dhe kështu rritet shtypja e gjakut. Kokaina mund të sjell tek çrregullimet fatale të ritmit të zemrës me pasoja vdekjeprurëse. Edhe pagjumësia e madhe si pasojë e kokainës mund ta rëndojë trupin në mënyrë ekstreme dhe të dërgojë në dekompensim. Kokaina sjell halucinacione pamore, ide të ndjekjes, çrregullime orientimi, nervozitet dhe agresivitet e nganjëherë edhe gjendje psikoze. Pas rënies së efektit vije tek gjendje depresiviteti. Për këtë arsye shtohet nevoja për dozën e ardhshme. Tek përdorimi i gjatë i kokainës vije tek ndryshimet në personalitet. Personi e humb arsyen dhe aftësinë e ndjeshmërisë, për këtë arsye njihet si ego-drogë. Kokaina të bën shumë shpejt të varur, para së gjithash psikikisht. Tek disa edhe pas një përdorimi të vetëm. Pas përdorimit të vazhdueshëm vije tek varësia trupore.Një formë tjetër e kokainës e ashtuquajtura **Crack** e cila përdoret si cigare vepron shumë shpejt dhe është shumë e rrezikshme. Një mbidozim ndodh shpejt dhe i cili mund të shpie tek ndërprerja e frymëmarrjes dhe arresti kardiak. Crack të bën shumë shpejt të varur psikikisht dhe fizikisht dhe mund të sjell tek çrregullimet e mushkërive, çrregullimet e qarkullimit të gjakut, shtypjes së gjakut, çrregullimet e oreksit etj. Përveç kësaj ndërron personalitetin. Konsumentët vuajnë nga çrregullimet e perceptimit, ose ndjehen persona të mëdhenj, të rëndësishëm ose në të

²³¹ .S.Stoilkoviq,Narkomania kao socio medicinski problem,Beograd,1972,f.8-10

²³² <https://en.wikipedia.org/wiki/Pharmacology>

²³³ <https://www.iph.mk/sq/26-qershori-dita-boterore-kunder-perdorimit-dhe-tregtise-ilegale-te-drogave/>

²³⁴ Halili,Ragip,Kriminologjia 2011,botimi I shtatë,f.308-311.

kundërtën shumë depresivë, janë shpirtërisht të humbur dhe vuajnë nga çrregullime ankthi. Një konsumim i gjatë sjell pasoja të papërmirësueshme.

Halucinogjenet-quhen kështu, pasi shkaktojnë halucinacione të cilat shfaqen në formën e iluzioneve. Mefjalë të tjera përdoruesi i këtyre llojë drogave “sheh”, përjeton dhe beson atë që nuk ekziston. Nga halucinogjenet mund të përmendim: Kanabis Sativa, L.S.D, Meskalini etj.²³⁵ Karakteristikë e këtyre drogave dehëse apo pijeve narkotike është se konsumuesi ndryshon krejtësisht personalitetin .Tek ata vërehen ndryshimet e raporteve ndaj rrethit shoqëror. Individidët e tillë humbin ndjenjen e realitetit, sistemi i tyre qëndror nervor ndërron në atë masë sa ata jetojnë në një botë të imagjinuar, në një botë fantastike, ireale dhe në një botë ëndërrash. Zakonisht këto droga dehëse i përdorin personat të cilët dëshirojnë ti ikin realitetit objektiv,duke ikur nga kushtet e caktuara jetësore dhe ekonomike materiale ku për një kohë jetojnë në iluzione dhe në botën e ëndërrave duke ikur për një kohë nga realiteti objektiv. Mirëpo nga pikëpamja morale këta persona degradohen, humbin autoritetin në shoqëri.

Nga kanabisi prodhohet hashashi, marihuana dhe ekstrakte kanabisi. **Hashashi** vjen nga frutet e kanabis sativës, ndërsa marihuana edhe nga perzierje gjethesh, lulësh dhe farëra te saja. Ekstrakti i kanabisit është lëng ngjithësisht i murrmë dhe i errët. Kanabis sativa ka nivelin më të lartë të konsumit në botë. Ajo është e vetmja bimë që rritet në Shqipëri dhe në numër shumë të vogël edhe në Kosovë. Sot ajo kultivohet në të gjitha kontinentet. Territorët ku kultivohet më tepër janë: India, Afrika e Veriut dhe Amerika Qendrore.Nga përdoruesit marihuana, hashashi dhe ekstraktet e kanabisit merren me pipë, cigare. Ato mund të merren prej tyre edhe pas përzierjes me pije ose me ushqimin. Përdorimi i tyre shkakton dremitje, shtrëmbërim të koncepteve “hapesirë” dhe “kohë”, halucinacione, ndjenjë lumturie e shoqëruar me ëndërra dhe shpërthime gazi. Kjo lloj droge vepron në kontekstin e trurit.Shpeshherë përdoruesi paraqet sjellje impulsive dhe agresive.

L.S.D -është shkurtimi i emrit Lusergic Dietylomid Saure- është zbuluar nga kimistët gjermanë Stoll dhe Hofman si preparat tek acidi liserxhik. Fillimisht kjo lloj droge pati përhapje tek konsumuesit, por aktualisht është kufizuar ndjeshëm sepse jep deformime tek fëmijët kur nëna është konsumatore e saj.**Depresantët**-në këtë grup bëjnë pjesë droga me veprim në sistemin nervor qendror, që kanë efekte qetësuese ose gjumëdhënëse. Tek depresantët perfshihen drogat me permbajtje opiumi si: opiumi, morfina dhe heroina. **Opiumi** -nxirret nga përpunimi i lulekuqes. vendet kryesore prodhuese te tij jane: India,Kina, Afganistani, Turqia, Egjipti, Meksika, etj.Vetia kryesore psiko-fiziologjike e opiumit është se vepron si ligështues i sistemit të lartë nervor, shkakton një gjendje euforie e shoqëruar me dremitje dhe ëndërra. Pihet me pipa të posaçme si duhan ose mund te gëlltitet si pije apo në formë pilulash. **Morfina**- është alkaloid natyral në forme pluhuri me shije të hidhur. Tretet në ujë, ne alkool, eter etj. Eshte qetësues i fuqishëm. Heq efektet e dhembjes dhe shoqërohet me eufori, shkakton nje gjendje gjumi dhe apatie, jep ndjenjen e mirëqenies dhe qetësisë.Efekti i veprimit të një marrjeje zgjat deri në 5-orë. **Heroina**- është drogë e rëndë dhe perfaqëson stadin e fundit të tyre. U prodhua në rrugë eksperimentale nga shkencëtari gjerman Dreser, si derivat i morfines për efekte mjeksore. Kishte një veprim shumë të fuqishëm në qetësimin e dhembjeve të sëmundjeve deri atëhere të pakurueshme. Për këtë arsye substanca e re u quajt heroine, pasi efektshmëria e saj mund të krahasohej me nje hero.Per shkak të këtyre vetive, shpejt u fut në trafikun ilegal të narkotikeve. Në fillim u prodhua fshehtas në Marsejë të Francës dhe më pas në Itali. E lehtë për trafikim sepse është e reduktuar në peshë dhe ka çmim shumë të lartë.Vendet kryesore prodhuese të heroinës janë trekëndëshi i artë: Tajlandë, Laos, Birmani, Azia e Vogël, Pakistani dhe Afganistani,Irani e Turqia. Kohët e fundit heroina prodhohet dhe në vendet e Amerikës Latine.Heroina është në formë pluhuri në ngjyrë të bardhe. Ajo nuk ka erë, ka shije të hidhur, tretet në ujë, në alkool dhe në eter. Ka efekte të ngjashme me ato të morfines, por 2-3 herë me të forta. Përdoret me injeksion ose në pije. Shkrihet me pak ujë në një lugë dhe para se të futet në shiringë për injektim ngrohet në flakën e një shkrepseje. Si ti njohim drogat- është shumë me rëndësi të dijmë se si ti njohim drogat me qëllim që qytetarët të mos bien pre e shpërndarësve të drogave.

Kuptimi i narkomanisë- sot më tepër se kurrë më parë narkomania si dukuri mjaft e rrezikshme dhe e dëmshme për shoqërinë është duke u paraqitur dhe ka dalë në sipërfaqe për fat të keq, sidomos tek struktura e të rinjëve. Narkomania, manifestohet në përdorimin dhe konsumimin e drogave dehëse dhe pijeve të tjera narkotike e mund të thuhet se kjo dukuri është e përhapur shumë në shoqërinë bashkëkohore. Duke e parë dinamikën e përhapjes së kësaj dukurie kriminale mjaft të dëmshme për shoqërinë, problematikat që ka sjellë ky fenomen, jo vetëm për mjeksinë por edhe në aspektin juridik kanë bërë që të tërhiqet vëmendja edhe e juristëve dhe opinionit të tërë për ta luftuar dhe parandaluar atë me të gjitha forcat e mundshme dhe në të gjitha mënyrat. Njerzit që abuzonin me drogën, jo vetëm që dëmtonin rëndë shëndetin e tyre, shëndërroheshin në persona asocial,duke qenë kështu kontigjenti shoqërorë më i prirur për të kryer krime të rënda. Ajo shkakton pasoja të rënda për shëndetin psikik dhe fizik të njeriut.²³⁶ Narkomania mund të sjellë në pyetje jo vetëm shëndetin e individit por edhe jetën e gjeneratave të tëra të njerzimit.

²³⁵ Po aty.

²³⁶ Halili,Ragip.Kriminologjia,botimi I VII 2011,Prishtinë,f.308

Sipas statistikave nderkombetare dhe atyre nacionale të cilat e përcjellin dukurinë e narkomanisë, sot flitet për shifra të mëdha prej miliona njerëzish të cilët përdorin dhe konsumojnë narkotikë dhe janë bërë viktime të saj. Poashtu qindra miliona njerëz në mënyra të ndryshme janë të kyqur lidhur me prodhimin, shitblerjen, organizimin e rrjetit tregtar për shpërndarjen dhe keqpërdorimin e saj kundërligjor për qëllimet delikuede e kriminale. Shënime dhe të dhëna të sakta të organizatave shoqërore, asociacioneve dhe institucioneve të ndryshme ndërkombetare dhe nacionale të cilat merren me trajtimin dhe studimin e dukurisë së narkomanisë, flasin për numrin e madh të njerëzve, e sidomos të rinjëve të cilët e kanë humbur jetën ose kanë ngelur invalid të përjetshëm për shkak të përdorimit dhe varshmërisë nga droga dehëse.²³⁷

Veçoritë individuale të narkomanëve: Narkomani si personalitet është i humbur emocionalisht, i papjekur, pasiv, depresiv dhe agresiv. Persona me neuroza ose psikopati të rënda. Shpesh infektohen edhe me HIV/ AIDS duke përdorur shiringat e njëjte, ata janë servil dhe të prirur të gënjejnë dhe të mashtrojnë, shoqërohen vetëm me narkomana dhe me individë të cilët janë problematikë. Narkomani trajtohet si faktor kriminogjen ku shumë narkomanë merren me veprime të ndaluara dhe kriminale. Merren me shitblerje dhe shpërndarje të drogës dhe nxitjen e të rinjëve ta marrin atë. Ata nuk zgjedhin mjete që të sigurojnë substanca të ndryshme narkotike, lëshohen në sjellje kriminale, ku në strukturën e sjelljeve të tilla jo rrallë kryhen edhe vepra penale prej atyre më të lehtëve deri te veprat e rënda penale, ndër të cilat më të shpeshta janë vrasjet, dhuna, mashtrimi, plaqkitja, terrorizmi e tjera. Arsyja themelore e aktivitetit kriminal të narkomanëve dhe një ndër format më të rrezikshme të kriminalitetit të organizuar me narkotikë, tregtia ilegale e këtyre lëndëve është se ata janë të varur për lëndë narkotike nga sëmundja e varësisë - narkomania dhe si pasojë e konsumimit të narkotikëve.

Një nga arsyet themelore e aktivitetit të tyre kriminal është sigurimi i pijeve të ndryshme narkotike, përkatesisht i mjeteve për ta blerë atë.

Ruga e vetme që të arrihet te lëndët narkotike është në të shumtën e rasteve kryerja e veprave penale kunder pasurisë, në rend të parë vjedhja. Së pari fillohet me vjedhje të vogla, e pastaj me vjedhje të rënda, grabitje, mashtrime deri te plaqkitjet e mëdha, thyerja e bankave, e argjendarive, shantazhet, dhuna fizike, madje edhe vrasjet. Shpesh herë, ata kur mbesin pa pije narkotike, thyjnë farmacitë, pasi për konsumimin e përditshëm të substancave narkotike atyre u nevojiten para të konsiderueshme dhe të mira materiale. Secili narkoman është delikuent potencial. Shumica e narkomanëve nuk punojnë, jo pse nuk janë të aftë për punë, por ngaqë nuk mund të fitojnë mjete për ekzistencë dhe në anën tjetër, për të blerë substancë narkotike, disa nga ata kryejnë edhe aktivitete kriminale. Mënyra e vetme që të fitojnë mjete (para) është veprimtaria kriminale sidomos vjedhjet, duke filluar nga më të voglat deri te vjedhjet më të rënda.

Mbi dhjetëra milion narkomanë në botë të cilët narkotik, çdo ditë kanë probleme se si të arrijnë deri te furnizimi me narkotikë. Narkomanët, si përfaqësues të një sub-kulture të re në botën e sotme bashkëkohore përherë kanë frikë se si të furnizohen me pije narkotike, që të mos mbesin pa to. Tek ata, frika e panderprerë nga kriza abstinenciale i shpjen qe pasurinë e fundit ta shesin për pije narkotike. Te sjelljet e ndryshme të narkomanëve asnjëherë nuk vlejnë normat etike.

Në fillim të shekullit të kaluar, prej 76 milionë banorëve qe kishte SHBA-ja, 100.000 prej tyre ishin narkomanë dhe në vit keqpërdorëshin 10 tonë pije të ndryshme narkotike prej nga filloi me të madhe të lindë kriminaliteti i organizuar me narkotikë si shkaktar i narkomanisë në shoqëritë e sotme bashkëkohëse. Tregtia e substancave narkotike konsiderohej punë normale ndërsa konsumimi i tyre nëpër disa vende konsiderohej si traditë e tyre për ritualet e mbajtura nëpër ato vende.

Më vonë filloi një lloj tregtie jo e rendomtë me lëndë narkotike, ku kësaj dukurie i kushtohet më shumë rëndësi dhe dimensione të reja - meqë, tregtia ilegale me narkotikë u bë burim ekzistence për shumë kultivues të bimës narkotike dhe shqetësim për bashkësinë shoqërore në botë.

Kriminaliteti i narkomanëve konsiderohet një ndër kriminalitetet e kryera nga persona "inteligjentë" dhe mashtrues të mëdhenj e të gjindshëm në çdo moment dhe situatë. Ata përdorin metoda të shumëllojshme në zhvillimin e rrjetit për bartjen e narkotikëve pavarësisht nga rrethanat se në çfare mase është sasia e lëndëve narkotike dhe e llojeve të narkotikëve. Kështu, në Afrikë dhe Azi përdoren kafshë ngarkese e sidomos deve nëpër shkretëtira e stepe të thata, ndërsa në Amerikën Jugore shfrytëzohen majmunët e dresuar dhe papagajtë që bartin kokainë në sasi të vogla narkotike. Metodë tjetër e bartjes së narkotikëve me sasi të mëdha janë qanta traste të punuara me dy shtresa, valixhe, torba, mbajtëse të foto aparatëve, qadër shiu e shumë e shumë sende të tjera.

Narkomanët përdorin edhe veshje të cilat kanë qepje speciale, po ashtu edhe kapelat,kravatat, kapëset e ndryshme, këpucët me dy shtresa llastiku e madje edhe bartje e fshehje të narkotikëve nën stomak të femrave shtatëzëna. Shpeshherë narkomanët substancat narkotike i ngjeshin me ngjitës special nëpër këmbë me paketime të ndryshme, sidomos në mes të këmbëve te pjesët e tulta, nën sqetulla, në sup apo në skajin e sipërm të shpatullave, nën gji, në

²³⁷ .S.Stoilkoviq,Narkomania kao socio medicinski problem,Beograd,1972,f.8-10

pjesët e gjirit të femrave, por ka edhe raste të fshehjes së narkotikëve me sasi të vogla edhe në organet gjenitale e në veqanti ato pije narkotike të cilësisë së lartë.

Narkomanët më së shumti e fshehin drogën apo pijet narkotike në gjërat që marrin me vete në udhëtim, bagazh dore, termose, frigorifer dore, në ushqime dhe gjësende për higjenë. Nëse udhëtojnë me automjet, narkotikët i fshehin në auto gomë rezervë, nëpër autobuse në zbrazëtira ku më së paku dyshohet, nëpër stilograf e disa edhe nëpër dërgesa postare. Arsyeja themelore e aktivitetit kriminal të narkomanëve është sigurimi i pijeve narkotike, perkatësisht parave për ta blere atë.

Rruga e vetme që të arrihet te substancat narkotike (materiet narkotike) është në të shumtën e rasteve kryerja e veprave penale kundër pasurisë, në rend të parë vjedhja. Po ashtu, gjatë këtyre aktiviteteve tek ata vijnë në mendje rrëmbimet, shantazhet, mashtrimet me gënjeshtër, dhunimet seksuale madje edhe vrasjet. Ajo që duhet të theksojmë është se një shtet që ka më shumë narkomanë, do të ketë më shumë kriminalitet. Me qëllim të zvoglimit të veprave kriminale janë bërë përpjekje të shumta për të nxjerrë ligje dispozita konkrete ligjore për luftimin e kësaj dukurie negative.

Pikëpamja nga ana e legjislacioneve: Vendet e para të cilat kanë nxjerrur dispozita konkrete ligjore për rregullimin e prodhimit të tregtisë dhe përdorimit të drogave dehëse janë: Franca, SHBA, Kina. Kodi Penal i Kosovës parashihet si veprë penale blerjen, posedimin, dhe shitjen e drogës. Narkomania si dukuri negative është në rritje, janë duke u marrë aksione dhe veprime konkrete edhe për nxjerrjen e dispozitave dhe ligjeve të veçanta për rregullimin e prodhimit.

OKB-ja lidhur me këtë çështje i ka kushtuar një sesion të veçantë i cili është mbajtur nga data 8-10 Qershor të vitit 1998 ku kanë marrë pjesë autoritete shtetërore nga mbarë bota.

Në këtë sesion ish-presidenti i SHBA Klinton e njoftoi opinionin ndërkombëtar për programin lidhur me parandalimin dhe luftimin e kësaj dukurie të dëmshme.

Ky program fokusohet:

-në reduktimin e prodhimit të lëndëve të para, kontrollin e rreptë të shpërndarjes dhe përpunimit, pengimin e larjes së parave që burojnë nga trafikimi i drogës, përsosjen dhe zgjerimin e bashkëpunimit të shteteve dhe organeve të tyre policore, gjyqësore dhe administrative në zbulimin dhe ndjekjen e kriminelëve dhe organizatorëve të këtij aktiviteti kriminal. Në këtë drejtim shumë autorë dhe studiues që merren me këtë problem theksojnë se ka nevojë të ndërmerren masa të tjera „në rend të parë masa të cilat janë të drejtuara kah eliminimi i shkaqeve dhe kushteve të cilat sjellin dukurinë e narkomanisë. Propozohen që të hartohen programe të natyrës sociale, ekonomike dhe edukativo- arsimore, veqmas insistohet në kyqjen e institucioneve shëndetësore dhe medicinale. Këto masa kanë për qëllim afrimin e ndihmës dhe rehabilitimin psikik dhe medicinal të narkomanëve dhe personave të cilët janë të varur nga drogat dhe substancat psikotrope.

Me marrjen e këtyre masave mendohet se do të pengohet dhe eliminohet kjo dukuri e rrezikshme e botës bashkohore.

3. VEPRAT PENALE TË NARKOTIKËVE SIPAS KODIT PENAL TË KOSOVËS

Brenda Kosovës, trafiku i drogës, nuk është në përmasa më të mëdha se sa në shtetet për rreth. Epërsi ka trafiku i heroinës dhe droga vjen nga Shqipëria, Turqia, dhe Maqedonia. Pra, shteti jonë nuk mund të konsiderohet shtet i origjinës por është shtet transit për mes të cilit droga bartet në shtetet tjera të rajonit dhe botës.

Republika e Kosovës se fundi ka miratuar Kodin e Ri Penal i datës 14 Janar 2019 në të cilin ka parashikuar një kapitull të veçantë për trajtimin e veprave penale të narkotikëve (**Kreu i XXIII nga neni 267 deri tek neni 276**) kështu duke i ashpërsuar dënimet më shumë në krahasim me Kodin e kaluar Penal të vitit 2013.²³⁸

Neni 267 Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge

1. Kushdo që pa autorizim blen ose posedon me qëllim të shitjes apo shpërndarjes, ose ofron për shitje substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në tetë (8) vjet .

2. Kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton, dorëzon, ndërmjetëson, dërgon ose dërgon në transit substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, dënohet me gjobë dhe me burgim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

²³⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës NR. 06/L-074
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

3. Kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca apo preparate të cilat janë shpallur me ligj si narkotikë, substanca psikotrope ose substanca analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.

4. Për qëllime të këtij kapitulli, shprehja “analog” nënkupton çfarëdo substance e cila nuk është e autorizuar dhe struktura kimike e së cilës është esencialisht e ngjashme me atë të substancave apo preparateve që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope dhe efektet e të cilave i riprodhon. 5. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

Neni 268 Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike

1. Kushdo që pa autorizim prodhon, kultivon, përpunon, nxjerr ose përgatit substanca apo preparate që janë shpallur si narkotikë ose substanca psikotrope, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

2. Kushdo që pa autorizim prodhon, kultivon, përpunon, shet ose ofron për shitje substancën analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në tre (3) vjet.

3. Kushdo që prodhon, transporton ose shpërndan preparate duke e ditur se ato do të përdoren për prodhim ose përpunim të paautorizuar të narkotikëve apo substancave psikotrope, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

4. Kushdo që pa autorizim prodhon, transporton, shpërndan, shet ose furnizon me vegla, pajisje apo materiale narkotike, duke ditur se këto janë përdorë ose do të përdoren për kultivim, prodhim, përpunim, trafikim apo përdorim të paautorizuar të çfarëdo substance ose preparati të cilat janë shpallur si narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

5. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.

Neni 269 Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge

1. Kushdo që pa autorizim posedon narkotikë, substanca psikotrope apo analoge, dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

2. Kryesi që kryen veprën nga paragrafi 1. i këtij neni për herë të parë dhe i cili posedon më pak se tre (3) gram të substancave narkotike apo substancave psikotropike ose analoge dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

3. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge konfiskohen.

Neni 270 Intoksikimi i personit tjetër me narkotikë ose substanca psikotrope Kushdo që e intoksikon personin tjetër me narkotikë, substanca psikotrope apo substanca analoge pa dijeninë e personit të tillë, dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet.

Neni 271 Lehtësimi i sigurimit apo përdorimit të narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge

1. Kushdo që administron me narkotikë, me substanca psikotrope apo analoge dhe për shkak të detyrës që ka, lehtëson sigurimin ose përdorimin e tyre në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

2. Drejtuesi ose pronari i lokalit apo i hapësirës tjetër të mbyllur që përdoret nga publiku, i cili lejon apo toleron përdorimin e narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në pesë (5) vjet.

Neni 272 Kultivimi i bimës së hashashit, shkurre së kokainës ose bimëve të kanabisit

1. Kushdo që pa autorizim kultivon bimën e hashashit, shkurren e kokainës ose bimën e kanabisit me qëllim të prodhimit të narkotikeve ose substancave psikotropike, dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.

2. Bima e hashashit, shkurrja e kokainës ose bima e kanabisit dhe furnizimet, pajisjet dhe materialet për kultivimin e tyre konfiskohen.

Neni 273 Organizimi, drejtimi apo financimi i trafikimit të narkotikëve apo substancave psikotrope 1.Kushdo që organizon, drejton apo financon ndonjë prej veprave penale nga ky Kapitull, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.

2.Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni përfshin sasi të madhe të narkotikëve apo substancave psikotrope, kryesi dënohet me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet.

Neni 274 Konvertimi apo transferimi i pasurisë që rrjedh nga veprat penale nga ky kapitull

1. Kushdo që e konverton apo transferon pasurinë, duke e ditur se pasuria e tillë rrjedh nga kryerja e cilësdo vepre penale nga ky Kapitull ose nga pjesëmarrja në veprën apo veprat e tilla, dhe konvertimi apo transferimi i tillë bëhet për qëllim të fshehjes ose mbulimit të origjinës së paligjshme të pasurisë apo të ofrimit të ndihmës personit i cili është i përfshirë në kryerjen e veprës apo veprave të tilla për t’u shmangur pasojave juridike të veprimeve të tij, dënohet me gjobë tre herë më të lartë se vlera e pasurisë së transferuar apo konvertuar dhe me burgim deri në dhjetë (10) vjet.

2. Pasuria e konvertuar apo e transferuar konfiskohet.

Neni 275 Dënimi për raste të rënda të veprave penale nga ky Kapitull

1. Nëse vepra penale nga nenet 267, 268, 269, 270 ose 272 të këtij Kodi kryhet në një ose më shumë nga rrethanat në vijim, kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, nëse:

1.1. kryesi vepron si anëtar i grupit;

1.2. kryesi është person zyrtar në keqpërdorim të pozitës apo autorizimeve të tij;

1.3. kryesi përdor ose kanos se do ta përdorë dhunën ose armën;

1.4. vepra kryhet në dëm ose duke e shfrytëzuar viktimën e ndjeshme;

1.5. dërgesa, ngarkesa, kontejneri ose mjeti i planifikuar për një operacion humanitar është përdorur për transportimin e paligjshëm të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge;

1.6. personi ka përzier substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge me substanca të tjera të cilat e shtojnë rrezikun për shëndetin;

1.7. vepra është kryer brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga shkolla apo mjedisi tjetër që përdoret nga fëmijët ose brenda perimetrit prej treqind e pesëdhjetë (350) metrash nga cilido institucion i edukimit;

1.8. vepra penale kryhet brenda institucionit korrektues;

1.9. vepra penale përfshin sasi të mëdha të narkotikëve, substancave psikotrope ose substancave analoge.

2. Substancat narkotike, substancat psikotrope ose substancat analoge dhe mjetet për prodhimin, shpërndarjen apo transportimin e tyre konfiskohen.²³⁹

Neni 276 Kompensimi ndaj zbatuesve të ligjit Kur personi dënohet për ndonjë vepër penale nga ky Kod, gjykata mund ta urdhërojë personin e dënuar që të bëjë kompensimin e cilësdo agjenci për zbatimin e ligjit, për shpenzimet e arsyeshme të bëra nga agjencia përkatëse në blerjen e narkotikëve ose substancave psikotrope nga ai person ose nga agjenti i tij si pjesë e hetimit që shpie në dënimin e tij.

Raporti Policor për përdorues të substancave narkotike, Janar- Korrik 2016: janë shënuar 429 raste të përdorimit të substancave narkotike në tërë Kosovë ku muaji Janar ka qenë muaji me numër më të vogël të rasteve ndërsa rekord ka shënuar muaji korrik me 93 raste. Prej tyre, 563 veta janë identifikuar si të dyshuar, 423 janë arrestuar, 156 veta janë ndaluar.

Prej këtij numri, janë identifikuar 507 shqiptarë, 10 serbë dhe 46 të tjerë.

Gjina e të dyshimëve për përdorim të substancave narkotike përfshin 549 meshkuj dhe 14 femra.

Policia e Kosovës ka ndaluar 387 veta për posedim të substancave narkotike, 35 veta për kultivim ndërsa ka identifikuar 8 grupe kriminale që merren me shitjen dhe shpërndarjen e substancave narkotike.

Gjatë hetimit të rasteve të tilla prej janarit deri në korrik ka realizuar 411 aksione policore për parandalimin dhe identifikimin e rasteve të përdorimit të substancave narkotike në Kosovë.

Statistikat për raste: Janar – Korrik 2016

	Raste t	Te dyshim t	Te arrestuar t	Te ndaluar t	Shqiptar t	Serb b	Te tjer e	Meshku j	Femr a	Trafiki m	Posedim m	Kultivim m	Operacion e	Gr. Kriminale e
2016														
Janar	46	52	36	11	48	1	3	51	1	8	45	1	46	0
Shkurt	54	82	63	23	76	2	4	81	1	18	52	2	49	1
Mars	51	90	65	36	78	2	10	86	4	16	51	3	51	3
Prill	67	84	57	27	77	0	7	83	1	15	62	6	66	0
Maj	59	75	62	23	68	2	5	74	1	11	53	3	56	2
Qershor	59	69	61	15	60	2	7	66	3	11	44	12	54	1
Korrik	93	111	79	21	100	1	10	108	3	7	80	8	89	1
Gjithsejt e	429	563	423	156	507	10	46	549	14	86	387	35	411	8

²³⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës NR. 06/L-074
<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

Sasia e konfiskuar e lëndëve narkotike Janar -Korrik 2016

Sipas shënimeve të Policisë së Kosovës në Kosovë përdoren këto substance narkotike: **heroina, marihuana, hashashi, kokaina, bimë kanabis, fara kanabis, ekstazy e droga të tjera.**

Nga këto lloje të drogave janë konfiskuar:

Heroinë: 19.55 gram,

Marihuanë 274 kg 318.26

Hashash 8 gram

Kokainë 87.8 gram

Bimë të kanabisit 1.603 kilogram

Fara kanabisi 2.486 kilogram dhe 3.58 gramë ndërsa Ekstazy 192.35 gram.²⁴⁰

Konfiskimet e drogës: Janar- Korrik 2016

2016	Heroina (g)	Marihuana (g)	Hashash (g)	Kokaine (g)	Bimë të Kanabisit	Fara kanabisi	Ekstazy	Droga të tjera (g)
Janar	0	2kg 021.2 gr	0	33.8 gr	8	0	0	2 hapa tramadol
Shkurt	0.55 gr	88 kg 583.5 gr	0	4	47	0	0	9 kg 614gr paracetamol me kafeine
Mars	10.1 gr	72kg 112.63 gr	0	0.1	0	46 +1.6 gr	0	0
Prill	0.2 gr	13 kg 004.4 gr	0	41.1 gr	33	2411	0	207 gota pastike të mbjellura me bime kanabisi
Maj	0	29 kg 183.2 gr	0	0	156	0	192	10 ml metadon me diazepam 1 cigare, 2 gjoint 0.9 gr ,
Qershor	5.5 gr	69 kg 205.3 gr	0	5.6	1223	2	0	2gjoint , 50 shishe të prera pergjysme me fara të mbjellura. 9 saksi të dyshuar të mbjellura me kanabis.
Korrik	3.2	208.03 gr	8 gr	3.2	136	27+1.98	0.35	3 gjoint 99 hapa. 242.7 gr speed, 11.8 gr panjohur 60 ml metadon
Gjithsejtë	19.55 gr	274 kg 318.26 gr	8 gr	87.8 gr	1603	2486 + 3.58 gr	192.35 gr	2 hapa tramadol. 9 kg 614gr paracetamol me kafeine, 207 gota pastike të mbjellura me bime kanabisi, 70 ml metadon me diazepam, 1 cigare, 8 gjoint , 50 shishe të prera pergjysme me fara të mbjellura 9 saksi të dyshuar të mbjellura me kanabis, 242.7 gr speed , 99 hapa. 11.8 gr panjohur.

Mosha më e preferuar e përdoruesve të drogave, prej 22 deri më 35 vjeç

Mosha më e preferuar e përdoruesve të substancave narkotike sillet prej 22 deri në 35 vjeç është 53% e përdoruesve , ndërsa 27% I takon moshës 19-21 vjeç, 11% të moshës mbi 35 vjeç, ndërsa 9% të moshës 14- 18 vjeç.

Mosha e personave të involvuar në rastet e drogave.

Mosha	2014	2015	2016
14-18	10%	12%	9%
19-21	25%	23%	27%
22-35	53%	53%	52%
Mbi 35	12%	12%	11%

²⁴⁰ Raporti Policor Qendra Prishtinë, periudha Janar -Korrik 2016

Lufta për parandalimin e narkomanisë.

Në planin ndërkombëtar në luftën kundër drogës, prodhimit, trafikimit, shitjes dhe formave të tjera kundër përdorimit të lëndëve narkotike, psikotrope të cilat paraqesin rrezik të theksuar shoqëror për jetën dhe shëndetin e njeriut doli në pah nevoja për disa ndryshime dhe plotësime që u bënë në ratifikimin e konventave e gjithë kjo duke u mbështetur në Ligjin për prodhimin dhe qakullimin e narkotikëve. Ky ligj parashikon dispozitat themelore, kushtet e prodhimit, importit dhe eksportit të narkotikëve, kushtet e qarkullimit të narkotikëve, evidence dhe mbikqyrja e prodhimit dhe qarkullimit të narkotikëve dhe dispozitat ligjore që parashihen për dënimin e prodhuesve, bartësve, shitësve dhe përdoruesve të narkotikëve.

Droga duhet luftuar që në fillimet e saj, për të ndaluar prodhimin, trafikimin dhe përdorimin e saj. Vendet e ndryshme po marrin masa të ndryshme për ndalimin e saj duke e vënë në dispozicion dhe fonde të mëdha financiare dhe mjete të shumta për parandalimin e narkomanisë, kapjen dhe vënien para përgjegjësisë së trafikantëve.

Veprat penale në lidhje me drogen janë ndër veprat më të rënda penale, pasi këto lloj veprash, si dhe konsumimi i drogave, prekin drejtpërdrejt shëndetin dhe jetën e njeriut.

Për të luftuar këtë fenomen duhet të forcohet zbatimi i ligjit në këtë fushë, përfshin edhe atë penal, duke dënuar me ashpërsi të gjithë autorët e këtyre veprave penale. Kjo kërkon shtimin në numër dhe specializimin e forcave të policisë, doganave dhe organeve të tjera.

Shteti duhet të luftojë mbjelljen e bimëve narkotike, prodhimin, trafikimin dhe shpërndarjen e substancave narkotike dhe psikotrope.

Po ashtu, nëpërmjet programeve të edukimit duhet t'iu shpjegohet qytetarëve dhe sidomos të rinjëve rreziqet që vijnë nga përdorimi i drogave.

Nëpërmjet programeve mjekësore duhet të nderpritet përdorimi i drogave nga përdoruesit duke ndaluar dhe infektimin e më tejshëm të ambientit. gjithashtu duhet adresuar politikatat dhe programet e saj tek fillimet e përdorimit të drogës, varfërisë, papunësisë dhe analfabetizimit.

4. PERFUNDIMI

Vrasës i heshtur dhe i pa mëshirshëm i miliona mijëra personave në tërë botën që po shkatërron shoqëri e shumë familje në botë, po shkakton kriza ekonomike e emocionale, vazhdimisht po rritet kjo dukuri e njerëzit po pësojnë nga ajo.

Në këtë frymë dhe me qëllim të parandalimit dhe evitimit të kësaj dukurie mjaftë të keqe dhe me qëllim të pengimit të përhapjes së kësaj "semundjeje kronike" të shoqërisë bashkëkohore që po shfaqet sidomos tek të rinjtë, e gjithë bota është alarmuar dhe ka ndërmarr masa duke përgaditur ligje e konventa, duke bërë përpjekje që droga të eliminohet dhe të zhduket kjo dukuri e përdorimit të saj në numër kaq të madhë. Shtetet e ndryshme të botës kanë bërë investime në institucione të sigurisë duke i përgatitur zyrtarët e policisë dhe doganave që të informohen dhe të paisen me teknologjinë dhe informacionet më inovative me qëllim të zbulimit të vendeve të prodhimit, laboratoreve dhe magacinave të drogës në mënyrë që të arrihet deri tek kapja e sasive të ndryshme të drogës dhe shpëtimit të jetëve të njerëzve.

Pasi që nga përdorimi i drogave nuk arrihet asgjë e mirë por vetëm shkatërrim i vetvetës dhe i të tjerëve duhet që të bëhet edhe sesibilizimi i shoqërisë dhe i të rinjëve që të kanë njohuri për dëmet që shkakton droga, mendoj se duhet të bëhet më shumë. Nuk mjafton të flitet për drogat vetëm në ditën ndërkombëtare të saj por duhet që në kurikulat mësimore të fëmijëve të flitet për të, fëmijët si pjesa më e ndishme e shoqërisë të ketë informacione për të dhe ta dijë qysh në vegjëli se ajo është diçka e keqe, e pastaj duke u rritur të mësoj edhe për efektet e saj, të shohë se si duket duke u informuar nga mësuesit që të ardhmen të mos jetë pre e ndonjë mashtrimi që e bie deri në përdorim të saj.

Shteti duhet që të hap institucione rehabilituese për personat e varur nga droga pasi që edhe ata janë pjesë e shoqërisë dhe duhet që të flitet me ta, të punohet me ta deri sa të largohen nga varshmëria e saj, të largohen nga bota e errët që janë futur dhe ta shohin botën përsëri me ngjyra duke kontribuar, shkolluar e punuar si persona të sukseshëm në shoqëri, e duke punuar ndoshta edhe si vullnetar që të ia zgjatin dorën edhe dikujt tjetër që ta nxjerrin nga gropa që janë futur.

LITERATURA E PËRDORUR

Elezi, I. (2005). "Për reformen në drejtësi", Tribunë juridike, nr.56,f.7

Halili, R. (2002). Kriminologjia, Prishtinë, fq 47

Halili, R.(2011). Kriminologjia, botimi I VII, Prishtinë, f.308

Kodi Penal i Republikës së Kosovës 2019 NR. 06/L-074

Nushi, S. (2004). Mbrojtja me avokat e personit gjatë kohës së shoqërimit, ndalimit ose arrestimit në flagrancë". Tribunë juridike, nr.46,f.51

Stoilkovic, S. (1972). Narkomania kao socio medicinski problem, Beograd, 8-10

<https://en.wikipedia.org/wiki/Pharmacology>

<https://www.iph.mk/sq/26-qershori-dita-boterore-kunder-perdorimit-dhe-tregtise-ilegale-te-drogave/>

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>